



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



RAPORT

MONITORIMI I MEDIAVE

GJATË FUSHATËS SË

ZGJEDHJEVE LOKALE 2017

RAUNDI II

*13 nëntor – 19 nëntor 2017
Prishtinë*

Përmbajtja

I. AKRONIMET E PËRDORURA NË RAPORT	3
II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
III. BAZA LIGJORE	5
IV. METODOLOGJIA DHE REALIZIMI	5
V. GJETJET NGA MONITORIMI	7
VI. SHKELJET E GJETURA DHE VEPRIMET E KPM-SË	7
<i>Pikat reklamuese politike të paignifikuar në mënyrë të duhur - shkelje e nenit 49.6 të Ligjit për Zgjedhje.....</i>	<i>8</i>
<i>Periudha e heshtjes zgjedhore (Ndalimi i përfshirjes në Media) - shkelje e nenit 52.1 të Ligjit për Zgjedhje</i>	<i>8</i>
<i>Mos ofrimi i Ditarëve me dhe pa pagesë - shkelje e nenit 53 të Ligjit për Zgjedhje.....</i>	<i>9</i>
VII. ANKESAT	10
VIII. HAPËSIRA E OFRUAR PËR SCP-të	10
<i>OSHMA-të me transmetim tokësor me mbulim nacional.....</i>	<i>10</i>
<i>OSHMA me transmetim tokësor me mbulim regional e lokal në regjionin e Prizrenit</i>	<i>14</i>
<i>OSHMA-të me transmetim tokësor me mbulim regional e lokal në regjionin e Mitrovicës</i>	<i>16</i>
<i>OSHMA-të me transmetim tokësor me mbulim regional e lokal në regjionin e Gjilanit.....</i>	<i>17</i>
<i>OSHMA-të me transmetim tokësor me mbulim regional e lokal në regjionin e Pejës.....</i>	<i>20</i>
<i>OSHMA-të me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes</i>	<i>21</i>

I. AKRONIMET E PËRDORURA NË RAPORT

- **KPM** - Komisioni i Pavarur i Mediave
- **KQZ** - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
- **DMA** - Departamenti i Monitorimit dhe Analizës i KPM-së
- **SCP** - Subjekt i Certifikuar Politik
- **OSHMA** - Ofrues i Shërbimit Medial Audio-Vizuel
- **MF** - Ministria e Financave
- **TV** - Televizion
- **DITARI** - Regjistër i evidencave të hapësirave që OSHMA-të kanë ofruar për SCP-të

II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dhëna me Ligjin Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i cili vlen edhe për Zgjedhjet Lokale, ka vazhduar monitorimin e OSHMA edhe gjatë raundit të dytë të fushatës për Zgjedhjet Lokale 2017.

Qëllim i monitorimit të bërë për periudhën 13 – 19 nëntor 2017 ishte vlerësimi i pajtueshmërisë së Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio–vizuale (OSHMA-ve) në pajtim me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, të titulluar “Mediat gjatë Fushatës së Zgjedhjeve”.

Në këtë monitorim janë përfshirë 24 ofrues të shërbimeve mediale audio-vizuale, prej të cilëve nëntëmbëdhjetë (19) janë OSHMA me transmetim tokësor që u takojnë kategorive me mbulim nacional, regional dhe lokal dhe pesë (5) OSHMA me program gjeneralistik që transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes. Raporti prezanton të gjeturat nga monitorimi i performancës së OSHMA-ve gjatë mbulimit të fushatës pesë (5) ditore si dhe heshtjes zgjedhore.

Gjatë procesit të monitorimit është vlerësuar paanshmëria në raportim, hapësira e ofruar për SCP-të, gjuha e përdorur si dhe pajtueshmëria me rregulloret përkatëse të KPM-së në edicionet e lajmeve, kronikat zgjedhore, intervistat, debatet dhe pikat reklamuese politike. Monitorimi është bërë për programet e transmetuara nga ora 16:00 deri në orën 24:00.

Edhe pse fushata për raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale 2017 ka filluar shumë kohë para shpalljes zyrtare nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), raporti përmban vetëm të dhënat për periudhën 13-19 nëntor 2017.

Gara për balotazh është organizuar në 19 komuna të Republikës së Kosovës, ndërsa në një (1) komunë është zhvilluar rivotimi për raundin e parë.

Në garë kanë marrë pjesë njëmbëdhjetë (11) Subjekte të Certifikuara Politike (SCP): Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) kanë garuar në dhjetë (10) komuna, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe LËVIZJA Vetëvendosje (VV) në gjashtë (6) komuna, ndërsa në nga një (1) komunë kanë garuar: Aleanca Kosova e Re (AKR), ALTERNATIVA, FATMIR RASHITI, GI KLOKOT VRBOVAC, NISMA dhe SRPSKA LISTA.

Në Komunën e Parteshit, në të cilën është zhvilluar rivotimi për zgjedhjet lokale, kanë garuar SCP-të: GI NARODNA SLOGA dhe SRPSKA LISTA.

Të gjeturat nga monitorimi dëshmojnë se prezantimi i raundit të dytë të fushatës për Zgjedhjet Lokale 2017 nga OSHMA-të është bërë kryesisht në mënyrë korrekte dhe të paanshme, në pajtim me dispozitat për media të përcaktuara në Kreun VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Kodin Etik për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.

III. BAZA LIGJORE

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet i cili përcakton në mënyrë specifike dispozitat për “Mediat gjatë Fushatës së Zgjedhjeve”.

Për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtueshmëri me Kreun VIII të këtij Ligji, KPM ka përcjell tek të licencuarit Udhëzuesin, i cili në fakt është interpretim më i detajuar i dispozitave të Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhje. Udhëzuesi përbëhet prej tre kapitujve:

1. KAPITULLI I – identifikimi i reklamimit politik;
2. KAPITULLI II – raportimi për hulumtimin e opinionit publik lidhur me zgjedhjet; dhe
3. KAPITULLI III – periudha e heshtjes zgjedhore.

Sipas nenit 53 të Ligjit për Zgjedhje, KPM siguron që të licencuarit mirëmbajnë ditarë për të regjistruar kohën e emetimit dhe ekspozimeve tjera në media, për reklamim me pagesë dhe pa pagesë, të aktiviteteve të fushatës për secilin SCP.

Për këtë qëllim, KPM u ka dërguar të licencuarve edhe format e ditarëve me dhe pa pagesë si dhe udhëzuesin për mënyrën e plotësimit të tyre. Gjithashtu, KPM ka kërkuar nga OSHMA-të të njoftojnë nëse do të mbulojnë garën për balotazh.

IV. METODOLOGJIA DHE REALIZIMI

Edhe në këto zgjedhje, metodologjia e përdorur gjatë monitorimit të performancës së ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuele, është bazuar në analiza sasiore dhe cilësore, me theks të veçantë në edicionet qendrore të lajmeve, kronikat zgjedhore, pikat reklamuese politike si dhe intervista e debate në përmbajtjet programore të transmetuara nga ora 16:00 deri në orën 24:00.

Metodologjia e monitorimit ka konsistuar në regjistrimin e programeve, kategorizimin e tyre, si dhe matjet e kohës/hapësirës së dedikuar secilit SCP. Gjithashtu, është bërë edhe dizajnimi i tabelave për futjen e të dhënave, vlerësimi i prezantimit të fushatës nëse ka qenë pozitiv, negativ apo neutral, përpunimi dhe analiza e të dhënave të fituara dhe në fund hartimi i raportit final lidhur me mbulimin medial të fushatës zgjedhore.

Nxjerrjen e këtyre të dhënave e mundësoi sistemi i monitorimit të cilin e posedon KPM, përmes të cilit bëhet pranimi, incizimi dhe arkivimi i programeve të transmetuara të OSHMA-ve.

Matja e hapësirës së dedikuar SCP-ve është bërë duke llogaritur kohën në sekonda (në lajme, intervista, debate dhe kronika zgjedhore). Bazuar në këto llogaritje, janë dhënë tabelat për kohën e ofruar për kandidatët, SCP-të në komuna dhe në përgjithësi për SCP-të në sekonda dhe përqindje.

Analizat janë bërë për të vlerësuar nëse:

- OSHMA-të kanë raportuar në mënyrë të drejtë dhe korrekte - raportimi objektiv dhe i paanshëm;
- OSHMA-të kanë ofruar mundësi për promovimin e platformave politike të SCP-ve/kandidatëve në garë;
- OSHMA-të kanë ofruar qasje të njëjtë për SCP-të në debate/intervista, pyetje të njëjta, mundësi për replikë në emisione debatuese, renditje të aktiviteteve zgjedhore në lajme e kronika zgjedhore (renditja me rotacion duke mos favorizuar prezantimin e aktiviteteve të SCP-ve me renditje të njëjtë për çdo ditë të fushatës); dhe
- OSHMA-të kanë vepruar në pajtueshmëri me heshtjen zgjedhore dhe dispozitat tjera të Ligjit për Zgjedhje.

Poashtu, gjatë analizës është bërë edhe vlerësimi për mënyrën e prezantimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të në pajtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës dhe standardet profesionale të gazetarisë (nëse ka pasur nxitje të urrejtjes, gjuhë të papërshtatshme, denigruese, fyerje, shpifje apo shkelje të dispozitave tjera të dhëna në Kodin e Etikës).

Të gjeturat në këtë raport janë të periudhës së monitorimit nga data 13 deri më 19 nëntor 2017.

Në monitorimin e fushatës për zgjedhjet lokale janë përfshirë: OSHMA-të me transmetim tokësor me mbulim nacional (*RTK1, TV21* dhe *KTV*), lokal/regjional (*TV OPINION, TV BESA, TV PRIZRENI, TV BALLKAN, TV MOST, TV MITROVICA, TV MIR, TV LIRIA, TV ILIRIA, TV TEMA, TV VALI, TV PULS, TV HERC, TV FESTINA, TV DUKAGJINI* dhe *TV SYRI VIZION*) dhe OSHMA-të me program gjeneralistik të cilët operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes (*RTK2, RROKUM TV, TV KIM, TRIBUNA CHANNEL* dhe *KLAN KOSOVA*).

Për shkak të problemeve teknike me arkivim të sinjalit në raport nuk është përfshirë *TV ZOOM* i cili edhe pas kërkesës së KPM-së nuk e ka sjellë arkivën e programit të transmetuar, duke e pamundësuar monitorimin e prezantimit të fushatës zgjedhore nga kjo OSHMA.

KPM për mos sjellje të arkivës edhe për periudhën e fushatës së raundit të parë të Zgjedhjeve Lokale ka sanksionuar TV Zoom-in me gjobë për shkelje të nenit 5, paragrafi 2, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

V. GJETJET NGA MONITORIMI

Gjatë raundit të dytë të fushatës për Zgjedhjet Lokale, OSHMA-të kanë vepruar kryesisht në pajtueshmëri me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, respektivisht Kreun VIII-të këtij Ligji.

Përmes hapësirës së ofruar me pagesë dhe pa pagesë, OSHMA-të kanë ofruar mundësi për shpалosjen e programeve politike të SCP-ve të cilët ishin pjesë e garës për balotazh 2017.

Raportimi i OSHMA-ve gjatë mbulimit të fushatës ishte kryesisht neutral, ndërsa në të shumtën e rasteve edhe renditja në prezantimin e fushatave të SCP-ve në edicionet e lajmeve ishte e balancuar dhe me rotacion.

Gjuha e përdorur në media gjatë kësaj fushate ka qenë kryesisht në pajtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale.

OSHMA-të me mbulim tokësor nacional si dhe ato të cilat transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes kanë mbuluar fushatën për balotazh në shumicën e komunave ndërsa, OSHMA-të me mbulim tokësor regjional dhe lokal përcollën kryesisht fushatën e kandidatëve të SCP-ve të cilat garuan në komunat ku ato operojnë.

Sa i përket distribuimit të kohës (sasisë së dhënë) në edicionet e lajmeve, OSHMA-të kanë ofruar hapësirë më të madhe kryesisht për SCP-të të cilat kanë pasur aktivitete dhe fushatë më të dendur si dhe ato që kanë garuar në më shumë komuna.

OSHMA-të të cilat transmetojnë në gjuhën serbe kanë transmetuar kryesisht fushatat e SCP-ve nga radhët e komunitetit serb.

Vlen të përmendet fakti se gjatë mbulimit të fushatës për balotazh nuk ka pasur transmetim të pikave reklamuese politike me prezencë të fëmijëve.

VI. SHKELJET E GJETURA DHE VEPRIMET E KPM-SË

Nga monitorimi i OSHMA-ve që kanë mbuluar fushatën zgjedhore për balotazh është vërejtur se disa OSHMA kanë vepruar në kundërshtim me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje. Lidhur me shkeljet e identifikuar, KPM ka iniciuar veprimet e parapara në pajtim me nenin 30 të Ligjit për KPM-në.

Shkeljet e evidentuara kanë të bëjnë me:

- Pikat reklamuese politike të paidentifikuara në mënyrë të duhur;
- Shkelje e heshtjes zgjedhore; dhe
- Mos ofrimi i Ditarëve A dhe B.

Pikat reklamuese politike të paidentifikuara në mënyrë të duhur - shkelje e nenit 49.6 të Ligjit për Zgjedhje

Gjatë monitorimit është vërejtur se disa OSHMA nuk e kanë bërë identifikimin e duhur të pikave reklamuese politike, siç parasheh neni 49 paragrafi 6 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili përcakton se:

“Transmetuesit përkujdesen që çdo pikë reklamuese politike të identifikohet qartë si e tillë dhe të tregojë qartë organizatën ose individin përgjegjës për të.”

RTK1 ka transmetuar pikat reklamuese politike të kandidatëve: Valdete IDRIZI, Agim BAHTIRI, Agim ALIU, Shaqir TOTAJ dhe Arban ABRASHI si: “Reklamë politike me pagesë”, duke mos e identifikuar qartë individin edhe/apo organizatën që e ka financuar/sponsorizuar atë.

Këto pika reklamuese politike kanë vazhduar të transmetohen edhe pas Njoftimit për Shkelje dërguar RTK1.

Për mos identifikim të duhur të pikave reklamuese politike ose hapësirave me pagesë (pikat reklamuese politike dhe tubimet e kandidatëve të SCP-ve: VV dhe PDK) në shkelje të nenit 49.6 është gjetur edhe TV PRIZRENI.

Për rastet e shkeljeve të identifikuara janë iniciuar procedurat e parapara ligjore.

Periudha e heshtjes zgjedhore (Ndalimi i përfshirjes në Media) - shkelje e nenit 52.1 të Ligjit për Zgjedhje

Gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, më 18 dhe 19 nëntor 2017, në kundërshtim me nenin 52.1 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhje dhe Udhëzuesin e KPM-së, OSHMA-të kanë transmetuar:

- Pika reklamuese politike të kandidatëve të SCP-ve;
- Konferenca për media të disa SCP-ve gjatë të cilave janë identifikuar elemente që i takojnë aktiviteteve të fushatës; dhe
- Reagimet e SCP-ve për parregullsitë dhe keqpërdorimet e ndryshme, në të cilat vërehen logot e SCP-ve.

Neni 52.1 i Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhje përcakton se:

“Asnjë person ose medium nuk transmeton ose publikon çfarëdo materiali që i takon aktivitetit të fushatës gjatë periudhës që fillon 24 orë para hapjes së vendotimeve deri në mbylljen zyrtare të vendotimeve”.

Në shkelje të heshtjes zgjedhore janë gjetur OSHMA-të:

- TV DUKAGJINI – ka transmetuar pjesë nga 2 pika reklamuese politike me kohëzgjatje prej 20 sekonda (kandidatit Shpend AHMETI nga SCP VV) dhe 10 sekonda (kandidatit Gani DRESHAJ nga SCP AAK).
- TRIBUNA CHANNEL – ka transmetuar konferencat e shtabeve zgjedhore të SCP-ve: AAK, PDK dhe VV, në të cilat janë vërejtur logot e këtyre SCP-ve;
- TV MOST – ka transmetuar aktivitete të fushatës si dhe logon e SCP SRPSKA LISTA dhe aktivitet të kandidatit nga SPC GI KLOKOT VRBOVAC;
- TV MIR – ka transmetuar aktivitet të fushatës së SCP SRPSKA LISTA; dhe
- TV PULS – ka transmetuar aktivitetin e fushatës së kandidatit nga SPC GI KLOKOT VRBOVAC.

Lidhur me shkeljet e identifikuar, KPM ka iniciuar rastet për procedim të mëtejshëm sipas procedurave të parapara ligjore.

Mos ofrimi i Ditarëve me dhe pa pagesë - shkelje e nenit 53 të Ligjit për Zgjedhje

Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, përkatësisht nenit 53, përcaktohet se:

“Komisioni i Pavarur për Media siguron se mediat mirëmbajnë një ditar për të regjistruar kohën e emetimit, dhe ekspozimeve tjera të mediave, për reklamim me pagesë dhe pa pagesë, të aktiviteteve të fushatës për secilën parti. Ditari i vlerëson të gjithë treguesit relevant të ekspozimeve, ndaras për secilin subjekt politik, sipas mënyrës së përcaktuar me rregullat e KPM-së”.

Në prag të fillimit të fushatës për balotazh, me datë 10 nëntor 2017, KPM ka përcjellë te të licencuarit format e Ditarëve me dhe pa pagesë të cilët duhet të mirëmbahen nga mediat, si dhe udhëzuesin për mënyrën e plotësimit të tyre.

Gjithashtu, nga të licencuarit është kërkuar ta njoftojnë KPM-në nëse do të mbulojnë fushatën zgjedhore. Në rast të mbulimit të fushatës është kërkuar që këta Ditarë t'i ofrohen KPM-së pas përfundimit të fushatës zgjedhore. Për rastet e mos dorëzimit të Ditarëve, KPM do të ndërmarrë veprimet përkatëse ligjore.

VII. ANKESAT

Gjatë periudhës së Raundit të Dytë të Zgjedhjeve Lokale, KPM nuk ka pranuar asnjë ankesë.

VIII. HAPËSIRA E OFRUAR PËR SCP-të

Të dhënat në tabelat më poshtë, lidhur me hapësirën e ofruar për SCP-të nga data 13 nëntor 2017 deri më 17 nëntor 2017, janë vetëm për periudhën kohore nga ora 16:00-24:00 gjatë së cilës është bërë monitorimi.

Për OSHMA-të të cilat nuk kanë ofruar debate dhe intervista gjatë periudhës së monitorimit janë paraqitur tabelat vetëm për hapësirën e ofruar në edicionet e lajmeve dhe kronika zgjedhore. Hapësira e dhënë në debate është llogaritur edhe për kandidatët e SCP-ve të cilët janë ftuar nga OSHMA-të, por që nuk kanë marrë pjesë në debat.

Në edicionet e lajmeve, kronikat zgjedhore dhe debatet e transmetuara, OSHMA-të kanë dedikuar këtë hapësirë për SCP-të:

OSHMA-të me transmetim tokësor me mbulim nacional

RTK1

Televizioni Publik i Kosovës RTK1, përveç garës në Kllokot, ka mbuluar garën e kandidatëve në të gjitha komunat ku është zhvilluar raundi i dytë i Zgjedhjeve Lokale 2017: Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Gjakovë, Gjilan, Klinë, Istog, Suharekë, Rahovec, Ferizaj, Obiliq, Podujevë, Kaçanik, Shtime, Malishevë, Dragash dhe Kamenicë.

Ndërsa, rivotimi në Komunën e Parteshit nuk është përcjell nga RTK1.

Gjatë prezantimit të garës elektorale, RTK1 ka ofruar hapësirën më të madhe në edicionet e lajmeve për Komunën e Prishtinës 19.6%, Gjakovës 13%, Mitrovicës 13.2%, Gjilanit 8.65% dhe Malishevës 6.17%.

Në përgjithësi, RTK1 ka raportuar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

Sa i përket hapësirës së përgjithshme të SCP-ve, RTK1 ka ofruar këtë mbulueshmëri në edicione të lajmeve: LDK – 27.87%, PDK – 23.89%, VV – 15.48%, AAK –13.10%, ALTERNATIVA – 7.94%, AKR – 6.23%, NISMA– 4.43% dhe Fatmir RASHITI – 1.06%.

Hapësira në edicionet e lajmeve dhe kronikave zgjedhore RTK 1		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
AAK	1600	13.10
AKR	761	6.23
ALTERNATIVA	970	7.94
FATMIR RASHITI	129	1.06
LËVIZJA VV	1890	15.48
LDK	3403	27.87
NISMA	541	4.43
PDK	2918	23.89
Total	12212	100

Ndërsa, në debate RTK1 ka ofruar hapësirë më të madhe për SCP-të: PDK – 28.63%, LDK – 25.15%, AAK – 17.56% dhe VV – 17.03%. Kjo, për faktin se këto SCP kanë garuar në më shumë komuna.

Hapësira në debate/intervista RTK 1		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
AAK	19857	17.56
AKR	3009	2.66
ALTERNATIVA	4020	3.55
FATMIR RASHITI	3119	2.75
LËVIZJA VV	19248	17.03
LDK	28431	25.15
NISMA	2974	2.631
PDK	32364	28.63
Total	113022	100

TV 21

Gjatë prezantimit të garës elektorale në edicionet e lajmeve, kjo OSHMA ka ofruar hapësirë më të madhe për: Komunën e Prishtinës 26.3%, Gjakovës 20.13%, Klinës 13.14%, Mitrovicës 10.81%, Ferizajt 9.62%, Gjilanit 5.57%, Prizrenit 5.18%, Podujevës 3.73%, Rahovecit 2.84%, Istogut 1.30% dhe Kamenicës 1.30%.

Gjatë periudhës monitoruese, TV21 nuk ka mbuluar garën e kandidatëve për kryetar të komunave: Obiliq, Shtime, Suharekë, Vushtri, Malishevë, Kllokot dhe Dragash si dhe rivotimin në Partesh. Në përgjithësi, TV21 ka raportuar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

Hapësira e dhënë për SCP-të në edicionet e lajmeve të TV21 është si vijon: LDK – 23.23%, PDK – 21.16%, VV – 19.83%, AAK – 15.95%, ALTERNATIVA – 12.64 % dhe AKR – 7.16%.

Hapësira në edicionet e lajmeve dhe kronikave zgjedhore TV 21		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
AAK	539	15.95
AKR	242	7.16
ALTERNATIVA	427	12.64
LËVIZJA VV	670	19.83
LDK	785	23.23
PDK	715	21.16
Total	3378	100

TV21 gjatë prezantimit të garës elektorale në debate ka ofruar këtë hapësirë: LDK – 39.58%, PDK – 31.22%, VV – 9.84%, ALTERNATIVA – 9.68% dhe AAK – 9.68%.

Hapësira në debate/intervista TV 21		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
AAK	2509	9.68
ALTERNATIVA	2509	9.68
LËVIZJA VV	2551	9.84
LDK	10263	39.58
PDK	8096	31.22
Total	25928	100

KTV

KTV gjatë prezantimit të garës elektorale në edicionet e lajmeve ka ofruar hapësirë më të madhe për komunitat: Prishtinë 67.23%, Istog 27.72%, Klinë 1.18%, Mitrovicë 0.97%, Ferizaj 0.66%, Malishevë 0.57%, Gjilan 0.58% dhe Gjakovë 0.57%. Ndërsa, gjatë periudhës monitoruese, nuk ka mbuluar garën e kandidatëve për kryetar të komunave: Prizren, Obiliq, Podujevë, Kaçanik, Rahovec, Shtime, Suharekë, Vushtrri, Killokot, Dragash, Kamenicë si dhe rivotimin në Partesh.

Hapësira e dhënë për SCP-të në edicionet e lajmeve për periudhën monitoruese të KTV-së është si vijon: LDK – 42.74%, VV – 35.56%, AAK – 19.57%, ALTERNATIVA – 0.39%, AKR – 0.50%. PDK – 0.84% dhe NISMA – 0.39%.

Hapësira në edicionet e lajmeve dhe kronikave zgjedhore KTV

SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
AAK	7583	19.57
AKR	195	0.50
ALTERNATIVA	151	0.39
LËVIZJA VV	13776	35.56
LDK	16561	42.74
NISMA	151	0.39
PDK	327	0.84
Total	38744	100.00

Gjatë periudhës monitoruese, KTV ka transmetuar vetëm debatin për komunën e Rahovecit.

Hapësira në debate/intervista KTV

SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
AAK	4449	50
PDK	4449	50
Total	8898	100

OSHMA me transmetim tokësor me mbulim regjional e lokal në regjionin e Prizrenit

TV OPINION

Në këtë OSHMA, fushata zgjedhore për balotazh gjatë periudhës monitoruese është mbuluar vetëm përmes edicioneve të lajmeve dhe ajo vetëm në Komunën e Prizrenit. Kandidatit të PDK-së i është dhënë hapësirë 73.2% kurse kandidatit të VV-së 26.8%. Mënyra e prezantimit në edicionet e lajmeve ishte neutrale.

Hapësira në edicionet e lajmeve dhe kronikave zgjedhore TV Opinion		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
LËVIZJA VV	910	26.8
PDK	2488	73.2
Total	3398	100

TV OPINION gjatë balotazhit nuk ka transmetuar debate.

TV BESA

TV Besa gjatë periudhës monitoruese të zgjedhjeve për balotazh ka mbuluar vetëm garën për kryetar të Komunës së Prizrenit. Raportimi në lajme ishte i balancuar për të dy kandidatët pjesëmarrës në garë. Kjo OSHMA-a për kandidatin Shaqir TOTAJ të SCP-së PDK ka ofruar 48.91%, kurse për kandidatin e SCP-së VV Mytaher HASKUKA 51.08%.

Hapësira në edicionet e lajmeve dhe kronikave zgjedhore TV Besa		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
LËVIZJA VV	4410	51.08
PDK	4222	48.91
Total	8632	100

Në debate/intervista ka ofruar 64.27% për Shaqir TOTAJ të SCP-së PDK, kurse 35.72% për kandidatin e SCP-së VV-së Myhaheer HASKUKA.

Hapësira në debate/intervista TV Besa		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
LËVIZJA VV	3383	35.72
PDK	6086	64.27
Total	9469	100

TV PRIZRENI

TV Prizreni gjatë periudhës së zgjedhjeve për balotazh ka mbuluar vetëm garën për kryetar komune në Prizren. Raportimi në lajme ishte i balancuar për të dy kandidatët pjesëmarrës në garë. Kjo OSHMA-a për kandidatin Shaqir TOTAJ të SCP-së PDK ka ofruar 47.48%, kurse për kandidatin e SCP-së VV, Mytaher HASKUKA 52.51%.

Hapësira në edicionet e lajmeve dhe kronikave zgjedhore TV Prizreni		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
LËVIZJA VV	1334	52.51
PDK	1206	47.48
Total	2540	100

Në debate/intervista ka ofruar 44.35% për Shaqir TOTAJ të SCP-së PDK, kurse 55.64% për kandidatin e SCP-së VV-së Mytaher HASKUKA.

Hapësira në debate/intervista TV Prizreni		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
LËVIZJA VV	2959	55.64
PDK	2359	44.35
Total	5318	100

TV BALLKAN

Nuk ka mbuluar fushatën zgjedhore të SCP-ve.

OSHMA-të me transmetim tokësor me mbulim regjional e lokal në regjionin e Mitrovicës

TV MOST

Kjo OSHMA gjatë periudhës së zgjedhjeve për balotazh ka mbuluar vetëm garën për kryetar komune në Kllokot. Kjo OSHMA-a ka ofruar hapësirë prej 67.51% për kandidatin e SCP-së SRPSKA LISTA Strahinja SPASIC, kurse kandidatit të SCP-së GI KLOKOT VRBOVAC Bozidar DEJANOVIC ka ofruar hapësirë prej 32.48%.

Hapësira në edicionet e lajmeve dhe kronikave zgjedhore TV Most

SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
GI KLOKOT VRBOVAC	102	32.5
SRPSKA LISTA	212	67.5
Total	314	100

TV MOST gjatë periudhës monitoruese nuk ka transmetuar debate ose intervista.

TV MITROVICA

Gjatë periudhës monitoruese, TV Mitrovica në garën për balotazh ka ofruar hapësirë vetëm për kandidatin e SCP-së AKR, Agim BAHTIRI. Ky medium ka njoftuar KPM-në se ka ofruar hapësirë pa pagesë për SCP-të garuese në komunat: Mitrovicë, Vushtrri, Obiliq, Prishtinë, Podujevë dhe Istog. Kjo hapësirë, sipas TV MITROVICA nuk është shfrytëzuar nga SCP-të.

Hapësira në edicionet e lajmeve dhe kronikave zgjedhore TV Mitrovica

SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
AKR	1502	100
Total	1502	100

TV MIR

Kjo OSHMA, gjatë periudhës monitoruese ka mbuluar në edicionet e lajmeve vetëm fushatën e SCP-së SRPSKA LISTA. Ndërsa, nuk ka transmetuar asnjë debat ose intervistë.

Hapësira në edicionet e lajmeve dhe kronikave zgjedhore TV Mir

SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
SRPSKA LISTA	98	100
Total	98	100

OSHMA-të me transmetim tokësor me mbulim regional e lokal në regjionin e Gjilanit

TV LIRIA

Kjo OSHMA gjatë periudhës monitoruese të zgjedhjeve për balotazh ka mbuluar vetëm garën për kryetar komune në Ferizaj. Raportimi në lajme ishte i drejtë dhe i paanshëm si dhe i balancuar në hapësirën e dhënë për të dy kandidatët pjesëmarrës në garë. Kjo OSHMA-a ka ofruar këtë hapësirë: 47.03% për kandidatin Agim ALIU të SCP-së PDK, kurse për kandidatin e SCP-së LDK Muharrem SVARQA 52.96%.

Hapësira në edicionet e lajmeve dhe kronikave zgjedhore TV Liria

SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
LDK	3335	52.96
PDK	2962	47.03
Total	6297	100

TV LIRIA gjatë periudhës monitoruese të zgjedhjeve për balotazh nuk ka transmetuar debate ose intervista.

TV ILIRIA

Kjo OSHMA nuk ka përcjellë fushatën zgjedhore për zgjedhjet lokale të raundit të dytë.

TV TEMA

OSHMA TV Tema gjatë periudhës monitoruese të zgjedhjeve për balotazh ka mbuluar vetëm garën për kryetar komune në Ferizaj. Raportimi në lajme ishte i balancuar dhe neutral. Kjo OSHMA-a ka ofruar këtë hapësirë: 47.20% për kandidatin Agim ALIU të SCP-së PDK, kurse për kandidatin e SCP-së LDK Muharrem SVARQA 52.79%.

Hapësira në edicionet e lajmeve dhe kronikave zgjedhore TV Tema

SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
LDK	1727	52.79
PDK	1544	47.20
Total	3271	100

TV TEMA gjatë periudhës monitoruese të zgjedhjeve për balotazh nuk ka transmetuar debate ose intervista.

TV VALI

Kjo OSHMA gjatë periudhës monitoruese të zgjedhjeve për balotazh ka mbuluar vetëm garën për kryetar komune në Gjilan. Në edicionet e lajmeve ka ofruar hapësirë më të madhe për kandidatin e SCP-së VV Sami KURTESHI 63.84%, kurse për kandidatin e SCP-së LDK Lutfi HAZIRI 36.15%.

Hapësira në edicionet e lajmeve dhe kronikave zgjedhore TV Vali

SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
LËVIZJA VV	1443	63.85
LDK	817	36.15
Total	2260	100

TV VALI gjatë periudhës monitoruese të zgjedhjeve për balotazh nuk ka transmetuar debate ose intervista.

TV PULS

Kjo OSHMA gjatë periudhës monitoruese të zgjedhjeve për balotazh ka mbuluar vetëm garën për kryetar komune në Klokot. Në edicionet e lajmeve ka ofruar hapësirë më të madhe për kandidatin e SCP-së GI KLOKOT VRBOVAC, Bozidar DEJANOVIC 71.63%, kurse për kandidatin e SCP-së SRPSKA LISTA, Strahinja SPASIC 28.36%.

Hapësira në edicionet e lajmeve dhe kronikave zgjedhore TV Puls

SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
GI KLOKOT VRBOVAC	149	71.63
SRPSKA LISTA	59	28.36
Total	208	100

TV PULS gjatë periudhës monitoruese të zgjedhjeve për balotazh nuk ka transmetuar debate ose intervista.

TV HERC

Kjo OSHMA gjatë periudhës së zgjedhjeve për balotazh ka mbuluar vetëm garën për kryetar komune në Kllokot. Në edicionet e lajmeve ka ofruar hapësirë më të madhe për kandidatin e SCP-së e SCP-së SRPSKA LISTA Strahinja SPASIC 76.37%, kurse kandidatit të SCP-së GI KLOKOT VRBOVAC Bozidar DEJANOVIC 23.62%.

Hapësira në edicionet e lajmeve dhe kronikave zgjedhore TV Herc

SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
GI KLOKOT VRBOVAC	60	23.62
SRPSKA LISTA	194	76.37
Total	254	100

TV HERC gjatë periudhës monitoruese të zgjedhjeve për balotazh nuk ka transmetuar debate ose intervista.

TV FESTINA

Nga monitorimi i bërë për fushatën zgjedhore të raundit të dytë është konstatuar se gjatë periudhës monitoruese OSHMA TV FESTINA nuk ka mbuluar fushatën për balotazh 2017.

OSHMA-të me transmetim tokësor me mbulim regional e lokal në regjionin e Pejës

TV SYRI VIZION

Kjo OSHMA gjatë periudhës së zgjedhjeve për balotazh ka mbuluar vetëm garën për kryetar komune në Gjakovë. Raportimi në lajme ishte neutral. Kjo OSHMA ka ofruar këtë hapësirë: 54.80% për kandidaten e SCP-së ALTERNATIVA Mimoza KUSARI LILA, kurse për kandidatin e SCP-së AAK Ardian GJINI 45.19%.

Hapësira në edicionet e lajmeve dhe kronikave zgjedhore TV Syri Vizion		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
AAK	7526	45.19
ALTERNATIVA	9128	54.81
Total	16654	100

TV SYRI VIZION gjatë periudhës së Zgjedhjeve Lokale për balotazh në debate ka dhënë hapësirë të barabartë për të dy kandidatët për kryetar të komunës së Gjakovës.

Hapësira në debate/intervista TV Syri Vizion		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
AAK	3322	50
ALTERNATIVA	3322	50
Total	6644	100

TV DUKAGJINI

Gjatë prezantimit të garës elektorale, TV DUKAGJINI ka mbuluar fushatën për balotazh në nëntë (9) komuna. Prej tyre, hapësirë më të madhe në edicionet e lajmeve i ka ofruar Komunës së Prishtinës 30.64%, ndërsa për komunat tjera ka ofruar këtë hapësirë: Gjakovë 24.53%, Gjilan 22.85%, Mitrovicë 9.63%, Klinë 4.44%, Rahovec 2.43%, Malishevë 2.22%, Ferizaj 2.18% dhe Prizren 1.09%. Në përgjithësi, ky medium ka raportuar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

Sa i përket hapësirës së përgjithshme të SCP-ve, TV DUKAGJINI ka ofruar këtë mbulueshmëri në edicionet e lajmeve: VV 36.40%, ALTERNATIVA 21.5%, AKR 6.23%, LDK 19.25% dhe PDK 15.27%.

Hapësira në edicionet e lajmeve dhe kronikave zgjedhore TV Dukagjini

SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
AAK	83	3.47
AKR	108	4.52
ALTERNATIVA	503	21.05
LËVIZJA VV	870	36.41
LDK	460	19.25
PDK	365	15.27
Total	2389	100

Në debate dhe intervista TV DUKAGJINI ka ofruar këtë mbulueshmëri për SCP-të: PDK 24.58%, VV 22.27%, LDK 19.63%, AAK 13.95%, ALTERNATIVA 10.13% dhe NISMA 9.40%.

Hapësira në debate/intervista

SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
AAK	8460	13.95
ALTERNATIVA	6145	10.13
LËVIZJA VV	13499	22.27
LDK	11900	19.63
NISMA	5698	9.40
PDK	14900	24.58
Total	60602	100

OSHMA-të me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes

RTK 2

Ky medium ka mbuluar fushatën për balotazh të SCP-ve nga radhët e komunitetit serb, garë kjo e cila në këtë raund është zhvilluar vetëm në Komunën e Klllokotit. Në edicionet e lajmeve për kandidatin e SCP-së SRPSKA LISTA ka ofruar hapësirë prej 73.51%, kurse për kandidatin e SCP-së GI KLOKOT VRBOVAC 26.48%. RTK 2 në lajme nuk ka përcjell garën e rivotimit në Komunën e Parteshit.

Hapësira në edicionet e lajmeve dhe kronikave zgjedhore RTK 2

SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
GI KLOKOT VRBOVAC	67	22.94
SRPSKA LISTA	225	77.05
Total	292	100

Ndërsa në debate dhe intervista RTK2 ka ofruar mbulueshmëri të barabartë për të dy kandidatët në garë për Komunën e Parteshit.

Hapësira në debate/intervista RTK 2

SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
GI NARODNA SLOGA	2962	50
SRPSKA LISTA	2962	50
Total	5924	100

RROKUM TV

Gjatë prezantimit të garës elektorale, RROKUM TV ka mbuluar fushatën për balotazh në nëntëmbëdhjetë (19) komuna të Republikës së Kosovës. Prej tyre, hapësirë më të madhe në edicionet e lajmeve i ka ofruar Komunës së Prishtinës 2.39%, ndërsa për komunat tjera këtë hapësirë: Gjakovë 11.76%, Mitrovicë 10.68%, Gjilan 4.27%, Prizren 5.19%, Kamenicë 7.07%, Malishevë 6.96%, Ferizaj 2.08%, Istog 2.82%, Obiliq 2.48%, Klinë 2.29%, Rahovec 2.89%, Podujevë 2.02%, Kaçanik 1.83%, Shtime 2.66%, Vushtrri 2.22%, Dragash 4.18%, Suharekë 1.56% dhe Kllokot 0.64%.

Sa i përket hapësirës së përgjithshme dhënë SCP-ve, RROKUM TV ka ofruar këtë mbulueshmëri në edicionet e lajmeve: LDK 26.16%, PDK 23.54%, VV 21.75%, ALTERNATIVA 10.25%, NISMA 5.60%, AAK 7.51%, NISMA 5.88% dhe AKR 2.61%. Në përgjithësi, ky medium ka raportuar në mënyrë korrekte dhe të paanshme.

Hapësira në edicionet e lajmeve dhe kronikave zgjedhore Rrokum TV

SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
AAK	327	7.51
AKR	114	2.61
ALTERNATIVA	446	10.24
FATMIR RASHITI	58	1.33
GI KLOKOT VRBOVAC	28	0.64
LËVIZJA VV	947	21.75
LDK	1139	26.16
NISMA	256	5.88
PDK	1038	23.84
Total	4353	100

RROKUM TV nuk ka transmetuar debate ose intervista gjatë periudhës monitoruese për balotazh.

TV KIM

Ky medium i cili transmeton në gjuhën serbe ka mbuluar fushatën për balotazh të SCP-ve nga radhët e komunitetit serb, garë kjo e cila në këtë raund është zhvilluar vetëm në Komunën e Kllokotit si dhe në Komunën e Parteshit, në të cilën është zhvilluar rivotimi. Në edicionet e lajmeve, TV KIM në Komunën e Kllokotit ka ofruar hapësirë për kandidatin e SCP-së SRPSKA LISTA me 91.50%, kurse kandidatit të SCP-së GI KLOKOT VRBOVAC i ka ofruar 8.49%. TV KIM në garën për Komunën e Parteshit ka ofruar hapësirë prej 62.45% për kandidatin e GI NARODNA SLOGA dhe hapësirë prej 37.54% për kandidatin nga SRPSKA LISTA.

Hapësira në edicionet e lajmeve dhe kronikave zgjedhore TV Kim

SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
GI KLOKOT VRBOVAC	13	3.14
GI NARODNA SLOGA	163	39.37
SRPSKA LISTA	238	57.48
Total	414	100

TV KIM gjatë periudhës monitoruese të Zgjedhjeve Lokale për balotazh nuk ka transmetuar debate ose intervista me përfaqësues të SCP-ve.

TRIBUNA CHANNEL

Gjatë prezantimit të garës elektorale, TRIBUNA CHANNEL ka mbuluar fushatën për balotazh në dhjetë (10) komuna të Republikës së Kosovës. Hapësirë më të madhe në edicionet e lajmeve i ka ofruar Komunës së Prishtinës 40.2%, ndërsa për komunat tjera ka ofruar këtë hapësirë: Gjakovë 22.6%, Prizren 6.20%, Vushtrri 6.0% Malishevë 5.6%, Ferizaj 5.2%, Mitrovica 4.8%, Rahovec 4.6%, Kaçanik 2.8% dhe Istog 2.1%.

Sa i përket hapësirës së përgjithshme dhënë SCP-ve, TRIBUNA CHANNEL ka ofruar këtë mbulueshmëri në edicionet e lajmeve: LDK 27.3%, ALTERNATIVA 22.67%, PDK 20.00%, VV-së 15.7%, NISMA 5.60%, AKR 4.80% dhe AAK 2.1%. Në përgjithësi, ky medium ka raportuar në mënyrë korrekte dhe të paanshme.

Hapësira në edicionet e lajmeve dhe kronikave zgjedhore Tribuna Channel		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
AAK	40	2.1
AKR	91	4.8
ALTERNATIVA	432	22.6
LËVIZJA VV	300	15.7
LDK	522	27.3
NISMA	108	5.6
PDK	420	22.0
Total	1913	100

Në debate dhe intervista TRIBUNA CHANNEL ka ofruar këtë hapësirë për SCP-të: VV 37.05%, PDK 32.07%, LDK 22.06, AAK 5.02% dhe NISMA 3.80%.

Hapësira në debate/intervista Tribuna Channel		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
AAK	1670	5.02
LËVIZJA VV	12322	37.05
LDK	7335	22.06
NISMA	1263	3.80
PDK	10666	32.07
Total	33256	100.00

KLAN KOSOVA

Gjatë prezantimit të garës elektorale, KLAN KOSOVA ka mbuluar fushatën për balotazh në njëmbëdhjetë (11) nga nëntëmbëdhjetë (19) komuna në të cilat ka pasur balotazh. Kjo OSHMA në edicionet e lajmeve i ka ofruar hapësirë më të madhe garës për Komunën e t Prishtinës 22.30%, ndërsa për komunat tjera këtë hapësirë: Mitrovica 18.60%, Gjilan 12.30%, Ferizaj 11.6%, Gjakovë 10.7.6%, Prizren 5.3%, Malishevë 7.3%, Rahovec 5.9%, Istog 5.8%, Prizren 5.3%, Klinë 3.5%, Kaçanik 2.30% dhe Malishevë 1.60%.

Sa i përket hapësirës së përgjithshme dhënë SCP-ve, KLAN KOSOVA ka ofruar këtë mbulueshmëri në edicionet e lajmeve: LDK 31.20%, VV 23.7%, PDK 17.00%, AKR 13.30%, AAK 9.80%, ALTERNATIVA 4.40% dhe NISMA 0.60%.

Hapësira në edicionet e lajmeve dhe kronikave zgjedhore Klan Kosova		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
AAK	475	9.8
AKR	645	13.3
ALTERNATIVA	214	4.4
LËVIZJA VV	1149	23.7
LDK	1514	31.2
NISMA	30	0.6
PDK	825	17.0
Total	4852	100

Në debate dhe intervista, KLAN KOSOVA ka ofruar këtë hapësirë për SCP-të: LDK 29.93%, VV 28.40%, PDK 27.47%, AAK 7.36%, NISMA 5.18% dhe AKR 1.63%.

Hapësira në debate/intervista Klan Kosova		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
AAK	4113	7.36
AKR	912	1.63
LËVIZJA VV	15856	28.40
LDK	16706	29.93
NISMA	2893	5.18
PDK	15336	27.47
Total	55816	100

#

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

Nëntor 2017